



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr.159 Akti**

**Nr. 197 Vendimi**  
**Tiranë, më 27.9.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 25 shtator 2019, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Dhurata Haveri**, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.5.2018, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.5.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioner Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)**, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, dhe pas komunikimit të Komisionit me këtë institucion me shkresën me nr. \*\*\*, datë 14.06.2019 ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*

<sup>1</sup> Raporti me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2018, dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.6.2019, ka depozituar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar shoqëruar me dosjen përkatëse, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016.

- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>.

**Këshilli i Lartë Gjyqësor** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5, e nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin e relatorit të çështjes në datën 16.9.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Subjekti në prapësimet e rezultateve të hetimit të depozituara në datën 15.7.2019, kërkoi të pyeten si dëshmitarë vëllezërit e bashkëshortit, për të provuar se nga shitja e apartamentit në Shkodër, subjekti ka përfituar shumën e plotë, ndryshe nga çfarë parashikon kontrata e shitblerjes e nënshkruar nga palët kontraktore, ku përfitues janë bashkëpronarët sipas pjesëve takuese.

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi prapësimet e subjektit dhe kërkesën për pyetjen e vëllezërve të bashkëshortit, ka gjykuar se Komisioni e bazon vendimin e tij mbi prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Për sa subjekti ka kërkuar që të provojë me dëshmi, ishte një fakt në favor të tij, i pambështetur në dokumentacion provues.

Gjithashtu, subjekti me kërkesën e datës 16.7.2019, drejtuar Komisionit, ka kërkuar: të njihet me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe të kontrollit të aftësive profesionale; dhe të njihet me përfundimin e procesit administrativ të rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit.

<sup>2</sup> Raporti me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, nga DSIK-ja, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*, datë 24.1.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, KLGJ-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 84/2016.

Referuar kërkesës së datës 16.7.2019, për njohjen me rezultatet e hetimit në lidhje me dy komponentët e tjerë të rivlerësimit (kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional), si dhe me përfundimin e procesit administrativ të rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, trupi gjykues ka argumentuar se në çdo rast procesi i rivlerësimit, në bazë të ligjit, fillon njëkohësisht për të tria kriteret e vlerësimit. Komisioni vlerësoi se provat e administruara deri në atë fazë të procesit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kanë arritur nivelin e provueshmërisë, janë të mjaftueshme dhe nuk përbëjnë shkak për përfundimin e procesit administrativ edhe për të dy komponentët e tjerë të rivlerësimit.

Për një proces të rregullt ligjor, znj. Dhurata Haveri, i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërja e trupit gjykues; si dhe përfundimi kryesisht i hetimit administrativ.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, datë 24.7.2019, subjekti u njoftua për rihapjen e hetimit administrativ për të kryer disa veprime hetimore, u njoh me mbylljen e hetimit shtesë, si dhe u njoh me rezultatet shtesë të këtij hetimi administrativ në datën 17 shtator 2019, duke i kaluar barrën e provës.

Znj. Dhurata Haveri u njoh me rezultatet e hetimit dhe paraqiti shpjegimet dhe provat e saj. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 24.7.2019, ora 13:00, në adresën: Pallati i Koncerteve, salla B, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe me avokaten znj. R. Z, të emëruar si përfaqësuese me prokurën e posaçme me nr. \*\*\*, datë 28.6.2019, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit, parashtrroi përpara trupit gjykues pretendimet e saj, si dhe kërkoi të administrohen me cilësinë e provës dokumentet origjinale të paraqitura prej saj në këtë seancë, të cilat ishin depozituar më parë si fotokopje të këtyre dokumenteve.

Trupi gjykues u tërhoq për të vendosur mbi kërkesën dhe për administrimin e dokumenteve origjinale, paraqitur nga subjekti dhe pasi i shqyrtoi ato në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi: të pranojë kërkesën për administrimin e dokumentacionit të paraqitur nga znj. Dhurata Haveri në seancë dëgjimore.

Trupi gjykues i mbledhur pas seancës dëgjimore, datë 29.7.2019, vendosi të rihapë procesin hetimor për të kryer disa verifikime shtesë për subjektin e rivlerësimit, në lidhje me kriterin e pasurisë. Pas mbylljes së hetimit shtesë, datë 17.9.2019, trupi gjykues i njoftoi subjektin të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ shtesë dhe e ftoi subjektin për seancën dëgjimore të datës 25 shtator 2019. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit personalisht, por u përfaqësua nga avokate znj. R. Z, e cila paraqiti prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit. Në përfundim të

kësaj seance, subjekti i rivlerësimit nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë e gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjithë rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar - Vetting dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) deklaratimet/provat shkrese të subjektit të rivlerësimit, me anë të komunikimit elektronik;

- f) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti ka deklaruar këto pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme:

**1. Apartament banimi<sup>4</sup>**, me sipërfaqe 135.9 m<sup>2</sup>, Rr. “M. B”, pall. P, Tiranë, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Vlera e deklaruar: 69.309 euro.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga + të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme, sipas kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, datë 28.6.2004, të apartamentit në Shkodër; kredi bankare të “BKT”-ja, dega Shkodër, kjo sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, nga “BKT”-ja.

Subjekti, në deklarimin e bërë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament:

- i. kredi në “BKT” në vlerën 2.126.600 lekë;
- ii. të ardhura nga shitja e apartamentit në Shkodër në shumën prej 2.600.000 lekësh;
- iii. huamarrje nga familjarë (emigrantë), si dhe kursime nga pagat në shumën 15.000 euro.

### 1.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

<sup>4</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën:

- Kontratë sipërmarrjeje për ndërtim apartament banimi tip E1, me sip. banimi 135.9 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, datë 19.5.2003, me vlerë 69.309 euro. Shuma 18.000 euro do të likuidohet në momentin e firmosjes së kontratës, kësti i dytë prej 20.000 euro do të paguhet në datën 1.8.2003, kësti i tretë prej 20.000 euro do të paguhet në datën 15.10.2003 dhe kësti i fundit prej 11.309 euro do të likuidohet me firmosjen e kontratës së shitblerjes së apartamentit pas hipotekimit; palë shitëse, shoqëria “Sh” sh.p.k., e përfaqësuar nga shtetasi L.S. dhe palë blerëse Dhurata Haveri dhe A. H.
  - Vërtetim bankar nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, nga BKT-ja, i cili konfirmon se shtetasja Dhurata Haveri ka marrë kredi në BKT-në Shkodër, në shumën 2.170.000 lekë, në datë 17.10.2003. Kjo kredi është mbyllur në datën 13.1.2015. Referuar dokumentacionit të administruar në ILDKPKI, nga BKT-ja rezulton se kredia është shlyer totalisht në datën 13.1.2005. (Aneks nr. 43)
  - Bashkëngjitur një pjesë e kontratës së kredisë në BKT, e cila fillon me nenin 1/1 të kësaj kontrate. Nga ky dokument vihet re se kredia është marrë në shumën 2.170.000 lekë, me afat 120 muaj.
  - Kontratë shitjeje me këste për apartament banimi tip 93/3, me sip. banimi 75.26 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, datë 10.10.2002, me vlerë bruto 2.132.883 lekë, nga të cilat përfitohet falas shuma prej 770.000 lekësh, për shkak të ligjit nr. 8647, datë 24.7.2000, dhe mbetet për t'u shlyer shuma prej 1.448.198 lekësh. Shuma 85.315 lekë është likuiduar me lidhjen e kontratës, ndërsa shuma 1.362.883 do të shlyhet për 25 vjet me këste 4.550 lekë/muaj; palë shitëse, Drejtoria Rajonale e Entit të Banesave Shkodër, e përfaqësuar nga shtetasi A. H dhe palë blerëse shtetasit A. H, A.H, Sh.H, A.H, A.H dhe A.H; bashkëngjitur planimetria, harta, vërtetimi i pronësisë dhe certifikata e pronësisë së apartamentit.
  - Kontratë shitjeje apartament banimi me pagesë të menjëhershme, për apartamentin tip 93/3 me sip. banimi 75.26 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, datë 20.2.2004, me vlerë 2.132.883 lekë, nga të cilat përfitohet falas shuma 770.000 lekë, për shkak të ligjit nr. 8647, datë 24.7.2000, dhe shuma e mbetur pa shlyer prej 1.448.198 lekësh do të përfitohet sërish falas për shkak se blerësi rezulton me statusin i pastrehë; palë shitëse Drejtoria Rajonale e Entit të Banesave Shkodër e përfaqësuar nga shtetasi A. H dhe palë blerëse shtetasit A. H, Sh. H, A. H, A. H dhe A. H.
  - Vendim nr. \*\*\*, datë 3.5.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin A. H. Nga kjo trashëgimi shtetasit A. H, Sh. H, A. H, A. H dhe A. H marrin secili nga 1/5 pjesë të pasurive dhe të detyrimit që mund të ketë lënë trashëgimlënësi.
  - Prokurë e posaçme nr. \*\*\* prot., nr. \*\*\* kol., datë 12.4.2004, me të cilën shtetasit Sh. H, A. H dhe A. H i japin tagër të plotë shtetasit A.H për kryerjen e veprimeve të nevojshme për realizimin e kontratës së shitblerjes së apartamentit ku janë në bashkëpronësi.
- Kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme, apartament banimi me nr. pasurie \*\*\* Z.K. \*\*\*, me sip. banimi 75.26 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\* datë 28.6.2004, me vlerë 2.000.000 lekë, shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Palë shitëse shtetasit A. H, Sh. H, A. H, A.H,A.H dhe palë blerëse shtetasi N. B.

**ZVRPP Tiranë**<sup>5</sup>, nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie në emër të subjektit dhe bashkëshortit.

## 1.2 Burimi i krijimit

Subjekti, në deklaratën “Vetting” për pasurinë apartament me adresë në Rr. “M.B”, ka deklaruar si burim krijimi:

- i. të ardhura nga paga;
- ii. të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme në Shkodër, sipas kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, datë 28.6.2004, para noterit V. H; dhe
- iii. kredi bankare te “BKT”-ja , dega Shkodër, sipas vërtetimit nr. \*\*\*prot., datë 20.10.2016, të lëshuar nga “BKT”-ja.

Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit për burimin e përdorur për blerjen e kësaj pasurie, nga ku vëren se:

**i.** Në lidhje me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti në pikën “i” mësipër, **“të ardhurat e krijuara nga pagat”**, Komisioni vëren se subjekti, as në deklaratat periodike vjetore por as edhe në pyetësit e pyetësorit nuk ka saktësuar shumat e kursyera, të cilat janë përdorur si burim për blerjen e apartamentit. Komisioni i ka kërkuar subjektit<sup>6</sup> që të saktësojë shumat e kursyera nga pagat të cilat janë përdorur për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti në pyetësit<sup>7</sup> e pyetësorit ka shpjeguar se:

*“Theksoj se, unë si subjekt përveç punës sime si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kam ushtruar funksionin edhe të pedagoges së jashtme pranë Universitetit “L G” në Shkodër, për 6 vjet, dokumentacioni për të cilën iu është vënë në dispozicion. Referuar kohës për të cilën flasim, informalitetit dhe minimumit jetik ndër vite, shuma e kursyer nga pagat e përdorur për mirëqenien ekonomike të familjes dhe pagimin e kësteve të detyrimit, për blerjen e banesës është maksimale.*

*Në lidhje me apartamentin e blerë, me sip. 135 m<sup>2</sup>, Rruga “M. B”, pall “P”, Tiranë, deklaroj se dominohet nga të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortëve Haveri...*

*Lidhur me dokumentimin e të ardhurave të realizuara nga ana ime si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vitet e kërkuara nga ana juaj, saktësoj se, unë kam punuar pa ndërprerje në sistemin gjyqësor, nga data 20 nëntor 1992 e në vazhdim. Për këtë vë në dispozicion librezën e punës, me nr. \*\*, regjistri themeltar, ku pasqyrohet vendimmarrja e organit kompetent KLD-së ndër vite, si dhe vërtetimin negativ, datë 19.1.2017, lëshuar nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku pasqyrohet fakti i njohur botërisht se institucioni i gjykatës, është djegur dy herë, në vitin 1997 dhe 1998.*

*Bashkëshorti im, z. A.H, ka punuar në vitet e kërkuara nga ju si (aktor) regjisor në Teatrin “M” , Shkodër, duke u emëruar si i tillë më 24 tetor 1991, pa ndërprerje deri në vitin 2003, dokumentacioni për të cilin ju është vënë në dispozicion në deklaratën e vitit 2017 (bashkëngjitur librezë e punës).*

<sup>5</sup> Në shkresën nr\*\*\* prot., datë 3.12.2018.

<sup>6</sup> Me pyetësorin e datës 22.4.2019.

<sup>7</sup> Pyetësorit datë 22.4.2019.

*Që nga viti 2003, jetoj në adresën: Njësia Bashkiake Nr. \*, Lagja; 'M. B', pall. 'P', kati \*, Tiranë e Re, banesë në të cilën vazhdoj të jetoj”.*

Për efekt të analizës financiare, Komisioni ka marrë në konsideratë të ardhurat sipas vërtetimeve zyrtare të lëshuar nga institucionet ku subjekti dhe bashkëshorti kanë punuar, si dhe kalimet e pagave në llogarinë bankare të tyre. Të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj janë trajtuar në mënyrë të detajuar, në pikën 1.4 si vijon.

**ii. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Shkodër**, si burim krijimi të deklaruar nga subjekti në pikën “ii” më sipër, ZVRPP-ja Shkodër ka depozituar kontratën për shitblerje pasurie të paluajtshme me nr. \*\*\*, datë 28.6.2004, apartament me sipërfaqe 75.26 m<sup>2</sup>, në çmimin prej 2.000.000 lekë. Në këtë kontratë si palë shitëse të pasurisë, në cilësinë e bashkëpronarëve figurojnë shtetasit: A. H; A. H; Sh.H; A. H; dhe A. H.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe të provojë, se si u përfitua nga bashkëshorti vlera e plotë, nga shitja e kësaj pasurie, në bashkëpronësi. Subjekti ka shpjeguar shprehimisht se: *“Lidhur me të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në Shkodër, në shumën prej 2.000.000 (dy milion) lekësh, janë përdorur totalisht nga ne si bashkëshortë në dispozicion të likuidimit të detyrimit, për banesën në Tiranë, ku dhe jetoj. Nga kontrata e shitjes ndërmjet Entit të Banesave Shkodër dhe nesh, është saktësuar pozita juridike e jona si shtetas, me cilësinë e statusit të të pastrehit. Referuar kushteve familjare, marrëdhëniet midis anëtarëve të familjes Haveri, kanë qenë të tilla që secili nga vëllezërit ka marrë pjesën takuese të objekteve të përfituara si nga privatizimi i banesave ashtu edhe nga rregullimi i marrëdhënieve pasurore midis njeri- tjetrit, për të cilat për sa kohë janë zgjidhur me marrëveshje midis tyre, nuk ka patur nevojë të bëhen me akte noteriale. Secili ka zgjidhur problemin e strehimit sipas mundësisë, marrëdhënie që nuk janë kontestuar nga anëtarët e familjes në vazhdimësi.”*

- Nga verifikimi i kryer Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë akt për të provuar pretendimet e saj, provë ku të shprehet vullneti i bashkëpronarëve të tjerë, për të hequr dorë nga pjesa takuese e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie, apo pjesën e tyre të përfituar t’ia kenë dhuruar bashkëshortit të subjektit.

Gjithashtu, nga verifikimi i akteve rezulton se të ardhurat nga shitja e apartamentit në Shkodër nuk mund të jenë përdorur si burim për blerjen e apartamentit, pasi pagesa e këstit të fundit prej 12.000 euro, është kryer në datën 14.6.2004, ndërsa të ardhurat sipas aktit të shitjes së apartamentit në Shkodër vijnë më pas, në datën 28.6.2004.

Gjithashtu, në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit në Shkodër u evidentuan mospërputhje, pasi në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti ka deklaruar shumën prej 2.600.000 lekësh, ndërsa sipas kontratës së shitjes çmimi i shitjes ka qenë 2.000.000 lekë. Në prapësimet e datës 23.7.2019, subjekti ka deklaruar se: *“Vlera prej 600.000 lekësh përtej çmimit të përcaktuar në kontratë, përfaqëson pasuritë e luajtshme që konsistojnë në mobilimin e banesës, sende që i janë shitur blerësit së bashku me apartamentin. Mungesa e dokumentimit vjen për arsye se mobilet kanë qenë të amortizuara, në kushtet e të qenurit sende të përdorura, dhe është e pamundur, për kohën kur kemi jetuar, për t’i përcaktuar vlerën e tyre në bazë të ndonjë akti shkresor. Ndaj dhe për këto arsye, i kemi llogaritur vlerën e sendeve për një shumë*



*totale prej 600.000 lekë, shumë e cila është pranuar nga blerësi pa patur nevojën e dokumentimit të tyre”.*

Komisioni arsyeton se subjekti nuk provoi faktin e pretenduar sa më sipër.

Gjithashtu, ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë me arsyetimin se në gjendje të amortizuar mobilet e këtij apartamenti janë shitur në çmimin 600.000 lekë, ndërsa vlera e mobilimit duhet të ketë kushtuar më shumë nga sa janë shitur. Për këtë arsye vlera e përfituar nga shitja e mobileve nuk mund të konsiderohet si fitim nga Komisioni.

Në përfundim, në lidhje me apartamentin në Shkodër, ka rezultuar se:

- Subjekti nuk provoi me dokumentacion se z. A. H ka përfituar vlerën e plotë nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi, si dhe nuk u provua se apartamenti u shit me një çmim më të lartë se sa ai i parashikuar në kontratë për efekt të shitjes së mobileve.

**iii. Në lidhje me burimin e tretë të deklaruar, kredi bankare,** te “BKT”-ja, ka konfirmuar se shtetasja Dhurata Haveri ka marrë kredi pranë “BKT”-së Shkodër, në shumën 2.170.000 lekë, në datën 17.10.2003. Referuar dokumentacionit të administruar në ILDKPKI rezulton se kredia është shlyer totalisht në datën 17.1.2005, në shumën prej 2.070.438 lekësh.

- Komisioni, referuar analizës financiare, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk kishte aftësi paguese për të shlyer kredinë në datën 17.1.2005.

1.3 Në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në Tiranë, subjekti<sup>8</sup> depozitoi 4 mandatpagesa me përshkrimin “depozitë në arkë” derdhur nga z. A.H. Referuar mandatpagesave të depozituara rezulton se për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka paguar shumën totale prej 58.000 euro, nga të cilat 46.000 euro janë shlyer në vitin 2003 dhe 12.000 euro janë shlyer në vitin 2004.

#### **1.4 Analiza financiare**

Komisioni ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mundësitë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj, për blerjen e këtij apartamenti, sipas pagesave të kryera, deri në datën 14.6.2004. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit, sipas tabelave vijuese. Të ardhurat nga punesimi i janë referuar vërtetimeve nga institucionet përkatëse, pranë të cilave kanë qenë të punësuar subjekti dhe bashkëshorti, si dhe pagave të referencës për vitet që nuk është disponuar dokumentacion për shkak të djegies së arkivave përkatëse.

Komisioni, për kryerjen sa më të saktë të analizës financiare, ka kërkuar informacione pranë institucioneve shtetërore, si vijon:

**Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor<sup>9</sup>** ka depozituar informacion në lidhje me pagat e gjyqtarëve në vite. Këto të dhëna janë përdorur si referencë për vitet që subjekti nuk depozitoi dokumentacion provues dhe që nuk disponohej informacion për pagat e përfituara të cilat janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

<sup>8</sup> Me pyetësorin e datës 22.4.2019.

<sup>9</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 2.9.2019.

**Arkivi i ISSH-së**<sup>10</sup> ka paraqitur të dhëna për z. A.H të cilat janë përfshirë në analizën financiare.

**Radio Televizionit Shqiptar**<sup>11</sup> ka depozituar informacion për pagat e z. A.H për vitet e punësimit pranë këtij institucioni.

**Teatrit Kombëtar**<sup>12</sup> ka depozituar informacion mbi pagesat në vite për regjisorë dhe aktorë të cilat janë marrë si referencë nga Komisioni, për të llogaritur të ardhurat nga punësimi i z. A.H në teatrin “M” Shkodër.

Referuar informacionit të administruar nga institucionet e mësipërme, Komisioni ka riformatuar të ardhurat e subjektit dhe të z. A. H sipas të dhënave të disponuara.

Për shkak të djegies së Arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>13</sup> ka pasur mungesë informacioni për disa vite dhe muaj brenda viteve. Për këtë arsye janë përdorur shkresat e administruara në dosjet e ILDKPKI-së, si dhe janë kërkuar dhe administruar nga Komisioni paga reference për pozicion të njëjtë. Përlllogaritja e pagave të subjektit është bazuar në informacionin e mëposhtëm:

- për punësimin gjatë periudhës 20.11.1992 – 31.12.1995, janë marrë paga reference<sup>14</sup>;
- për periudhën 1.1.1996 – 31.12.1998, shkresa e ISSH-së nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, e administruar nga dosja e ILDKPKI-së;
- për periudhën në mes të korrikut – shtator 1996, subjekti rezulton të ketë qenë me leje lindje, por ISSH-ja nuk ka sjellë të dhëna për vlerat e paguara. Përlllogaritja nga Komisioni i shumës së përfituar nga lejelindja është përlllogaritur si 80% e pagës së muajve paraardhës;
- për vitin 1999 janë marrë paga reference sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2019, dhe Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor;
- për periudhën 1.1.2000 – 20.2.2004, të ardhurat janë llogaritur sipas informacionit të disponuar me shkresën nr \*\*\* prot., 20.10.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër;
- për periudhën 21.2.2004 – qershor 2004, të ardhurat janë përlllogaritur sipas shkresës nr. \*\* prot., 24.10.2016, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

Për punësimin e subjektit, si pedagoge e jashtme në Universitetin “L. G” Shkodër, rezultojnë dy përgjigje nga ky institucion, si vijon:

- shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, e cila informon se subjekti ka qenë pedagoge e jashtme për vitet akademike 1992-1993, 1993-1994, 1994-1995, 1995-1996 dhe 2001-2002.
- shkresa nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, na informon për dy pagesa të bëra në vitin 1993 dhe në vitin 1994.

Ky është një universitet shtetëror dhe detyrimet janë paguar nga vetë institucioni. Bazuar në dokumentet që disponohen përlllogaritjet janë bërë, si më poshtë:

- një semestër i vitit 1992 është marrë i barabartë me vitin 1994;
- vitet 1993 dhe 1994 janë sipas listpagesave, bashkëlidhur vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016;

<sup>10</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2019

<sup>11</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 5.8.2019.

<sup>12</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 5.8.2019.

<sup>13</sup> Shkresa, datë 19.1.2017, e Gjykatës së Rrethit Shkodër.

<sup>14</sup> Bazuar mbi informacionin e disponuar sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2019, e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

- për vitet që mungojnë është konsideruar mesatarja (4.223 lekë) e shumave të paguara për vitet 1993 dhe 1994, të dyja sipas informacionit disponuar nga universiteti për vitet respektivë kalendarikë, pavarësisht se nuk kemi asnjë informacion për numrin e orëve të mësimdhënies.
- Për vitet 2001 dhe 2002, pagesa nga universiteti është ponderuar me masën në % të inflacionit zyrtar<sup>15</sup> të çdo viti, me bazë mesataren e viteve 1993 dhe 1994 (si më sipër).

**Të ardhurat e bashkëshortit për periudhën tetor 1991 – qershor 2004 (tabela 2)**

- Për shkak të djegies së arkivit të Teatrit “M” Shkodër ka mungesë informacioni për pagën e disa viteve dhe të disa muajve brenda viteve. Për këtë arsye janë përdorur shkresat e administruara në dosjet e ILDKPKI-së, si dhe janë kërkuar dhe administruar nga Komisioni paga reference për pozicion të njëjtë. Të ardhurat nga pagat për bashkëshortin janë reflektuar në analizën financiare sipas informacionit të marrë, sa më poshtë vijon:
  - periudha 25.10.1991 – 31.12.1993, janë marrë paga reference sipas shkresës. \*\*\* 05.08.2019, të T. K;
  - periudha 1.1.1994 – 31.12.1996, paga bruto sipas shkresës nr. \*\* prot., datë 25.1.2017, e Bashkisë Shkodër;
  - periudha 1.1.1997 – 31.12.1999, janë marrë paga reference sipas shkresës nr. \*\*\* datë 5.8.2019, të T. K;
  - periudha 1.1.2000 – 31.12.2001, paga bruto sipas shkresës nr. \*\* prot., datë 25.01.2017, e Bashkisë Shkodër.
  - periudha 1.1.2002 – 30.6.2003, paga neto sipas shkresës nr. \*\* prot., datë 24.01.2017, e Bashkisë Shkodër.

<sup>15</sup> Sipas raportit të Bankës së Shqipërisë <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/71/Historik-i-Inflacionit-në-Shqipëri>

**Tabela 1 Të ardhurat e subjektit për periudhën 1992 – qershor 2004**

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	Qershor 04	Total
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	2 933	50 550	148 800	232 000	226 527	247 202	340 762	485 160						1 733 934
Universiteti Luigj Gurakuqi	2 328	6 118	2 328	4 645	5 807					10 649	10 990			42 865
Gjykata e Apelit Shkodër									458 915	561 708	627 205	856 253	158 208	3 052 381
Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë													390 096	390 096
<b>Totali</b>	<b>9 051</b>	<b>56 668</b>	<b>151 128</b>	<b>238 118</b>	<b>232 645</b>	<b>247 202</b>	<b>340 762</b>	<b>402 664</b>	<b>458 915</b>	<b>572 928</b>	<b>638 784</b>	<b>856 253</b>	<b>548 304</b>	<b>4 829 181</b>

Të ardhurat e dokumentuara për subjektin, për periudhën 1992 - qershor 2004, rezultojnë të jenë në shumën **4.829.181 lekë**.

**Tabela 2 Të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 1991 - qershor 2004**

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	06/ 2004	Total
Të ardhura si regjizor pranë Teatrit “M” në Shkodër	2 181	18 428	41 444	53 178	76 732	103 890	164 640	201 908	141 593	162 540	177 900	177 216	88 608	-	<b>1 410 258</b>
<b>Totali</b>															

Të ardhurat e dokumentuara për periudhën 1991 – 2002 për z. A. H rezultojnë të jenë në shumën **1.410.258 lekë**.

**Të ardhurat familjare për periudhën tetor 1991 – qershor 2004 janë në total 6.239.439 lekë.**

**Analiza financiare për apartamentin e blerë në Tiranë, në adresën: Rr. “M. B”**

	<b>Pasuri</b>	<b>9 571 693</b>
	Autoveturë	300 000
	Ap. me sip. 135 m <sup>2</sup> , Rr. “M. B”, Tiranë 2003	9 263 148
	<i>Ndryshim i likuiditetit</i>	8 545
	<b>Detyrime</b>	<b>3 673 701</b>
	Kredi BKT	2 079 333
	Detyrim ndaj kompanisë së ndërtimit “Sh”	1 594 368
1	<b>Pasuri neto (Pasuri - Detyrime)</b>	<b>5 897 992</b>
2	<b>Të ardhura</b>	<b>6 239 439</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	4 829 181
	Të ardhura bashkëshorti	1 410 258
3	Shpenzime	3 421 460
	Shpenzime jetese	<b>3 192 222</b>
	Shpenzime interesi kredia “BKT“, 2.1 milionë lekë	229 238
	<b>Mundësia për kursime (2-3-1)</b>	<b>-3 080 013</b>

*Kursi mesatar i këmbimit për vitin 2003 dhe 2004 është respektivisht 1 euro = 133,65 lekë dhe 1 euro = 126,74 lekë*

Nga analiza e fakteve ka rezultuar se:

Apartmenti është blerë në vitin 2003 për shumën 69.309 euro (9.263,148 lekë) të cilat janë paguar 46.000 euro gjatë vitit 2003 dhe 12.000 euro në 14.06.2004. Gjithsej është paguar shuma 58.000 euro dhe detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë “SH” sh.p.k., është në shumën 11.309 euro.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” si detyrim ndaj shoqërisë “Sh” sh.p.k., shumën 10.000 euro dhe jo shumën reale të detyrimit sa më sipër.

Për këtë arsye nga Komisioni është bërë analiza financiare deri në momentin e pagesës së fundit prej 12.000 euro, në datën 14.6.2004.

Të ardhurat janë trajtuar sa më sipër.

Shpenzimet janë si vijon:

a. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas metodologjisë:

- nga viti 1991 deri në 1996, shpenzimet janë llogaritur 70% të të ardhurave familjare;
- nga viti 1997 deri në vitin 1999 shuma 5.000 lekë/muaj/për person;
- viti 2000 dhe në vijim, sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja me të dhënat bazuar në INSTAT.

b. Shpenzimet për pagesat e interesave të kredisë bankare.

- Nga analiza financiare e kryer deri në datën 14.6.2004, vërehet se, subjekti ka rezultuar me një mungesë financiare burimesh të ligjshme, apo balance negative në shumën - 3.080.013 lekë, për të cilën Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës.

## **1.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

**1.5.1** Subjekti në prapësimet e datës 23.9.2019 ka pretenduar se:

- konstatimet e Komisionit sipas rezultateve të hetimit janë të pambështetura në nenet C, D, DH dhe E të Aneksin të Kushtetutës, në ligjin nr. 84/2016, dhe në kuadrin ligjor shoqëruar mbi të cilin është bazuar ky proces;
- është arritur në kushtet e mospasjes në konsideratë të të gjitha provave të depozituara në respektim të ligjit si gjatë hetimit, ashtu edhe pasi iu kalua barra e provës;
- të pabazuara në provat e administruara;
- nuk është në kushtet e nenit D të Kushtetutës dhe se nuk ka dyfishin e pasurisë, sikurse kërkohet si kusht nga kjo dispozitë, për këtë arsye ka kërkuar konfirmimin në detyrë.

**1.5.2** Subjekti argumentoi se metodologjia e llogaritjeve financiare të kryera nga Komisioni mungonte në dosjen e saj. Për këtë arsye, në parashtrimet e saj subjekti i ka kërkuar Komisionit që të sqarojë metodologjinë e përdorur përfshirë legjislacionin, vlerat e referencës, standardet dhe formulën e përdorur në arritjen e konkluzioneve financiare. Nga Komisioni nuk është vënë në dispozicion as metodologjia dhe as elementi kryesor, i formulës së përdorur, fakt i cili vë në dyshim mënyrën dhe procedurën e drejtë të një hetimi administrativ.

Subjekti ka pretenduar se duke qenë se nuk është njohur me metodologjinë financiare i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur, për të paraqitur prova dhe shpjegime të kundërta, si dhe i është mohuar e drejta për të debatuar sipas parimit të kontradiktoritetit. Bazuar sa më sipër, subjekti ka argumentuar se Komisioni në shqyrtimin e çështjes duhet të udhëhiqet nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke mos cenuar garancitë e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuara nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016.

**1.5.3** Subjekti, në lidhje me provat e administruara nga Komisioni dhe nga institucionet shtetërore, ka kundërshtuar vlefshmërinë ligjore të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2019, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, me pretendimin se ky akt është lëshuar nga kancelaria e këtij institucioni (në mungesë të zv/kryetares), e cila në kuptim të ligjit organik nuk ka pasur dhe nuk ka *tagër* përfaqësimi të institucionit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kancelaria e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda nuk ka pasur asnjë *tagër* ligjor dhe kompetencë funksionale për të nënshkruar dhe hartuar përgjigje të tilla, në thelb të pavërteta, për llogari të institucionit gjyqësor. Subjekti pretendon se në përgjigjen e ardhur jepen informacione të pasakta të cilat janë pasqyruar në analizën financiare.

**1.5.4** Subjekti ka argumentuar se nga formulimi i pikave 4 dhe 5, të nenit D, të Kushtetutës arrihet në konkluzionin se:

- kur subjekti deklaron të ardhura që janë më shumë se pasuria e ligjshme, por pa e kaluar dyfishin e saj, për të cilën nuk janë paguar detyrimet tatimore, por arrin të provojë burimin e ligjshëm të krijimit;
- kur subjekti nuk përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, ai nuk prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore dhe nuk shkarkohet.

Subjekti argumenton se bazuar në të gjitha provat e administruara, si dhe në shpjegimet e saj, ekzistojnë të gjitha provat që provojnë arritjen e nivelit të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kontrollin e figurës, si dhe nivel të lartë në vlerësimin e aftësive profesionale.

## 1.6 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

**1.6.1** Sipas subjektit gjetjet e Komisionit nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe të gjitha provat e depozituara prej saj nuk janë marrë në konsideratë, por pa iu referuar konkretisht kujt prove. Në fakt, Komisioni, pas riçeljes së hetimit është investuar kryesisht për të disponuar informacionin që subjekti kishte detyrimin ligjor t'i depozitonte për të provuar burimet e ligjshme e për të cilën i ishte kaluar barra e provës. Referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme, për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”*.

**1.6.2** Komisioni arsyeton se për një proces të rregullt ligjor subjektit i janë dhënë mundësitë për të paraqitur prova dhe prapësime gjatë të gjithë procesit, si nëpërmjet pyetësorëve, ashtu edhe me kalimin e barrës së provës. Subjektit me kalimin e barrës së provës i është vënë në dispozicion analiza financiare mbi të ardhurat, shpenzimet dhe shpjegimet sipas aplikimit të tyre, ku tregohet qartë metodologjia e kryer.

**1.6.3** Komisioni, në lidhje me pretendimin e subjektit për pavlefshmërinë e dokumentit nënshkruar nga kancelaria e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, argumenton se subjekti konteston anën formale dhe materiale të kësaj shkrese. Subjekti, në lidhje me pretendimin se shkresa përmbante fakte të pavërteta, nuk depozitoi provë për të provuar të kundërtën. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezultoi se gjatë periudhës që ka qenë me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, nuk ka kryer asnjë udhëtim pune, e autorizuar si përfaqësuese e këtij institucioni. Ky fakt u konfirmua nga përfaqësuesja ligjore e subjektit në seancën e datës 25.9.2019. Për pasojë kundërshtimi që i ka bërë aktit se është lëshuar në kushtet e pavlefshmërisë absolute, nuk sjell pasoja në analizën financiare.

Duke iu referuar prapësimeve të subjektit për udhëtimet e kryera gjatë kohës që ka ushtruar detyrën si gjyqtare, udhëtimi i kryer në vitin 2015, në Holandë (sipas dokumentacionit të depozituar), nuk i është përfshirë si shpenzim në analizën financiare që i është dërguar subjektit me rezultatet e hetimit të datës 17.9.2019.

- Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**2. Apartament banimi<sup>16</sup>**, me sip. 111.5 m<sup>2</sup>, blerë më 4.2.2011, në Shkodër, me kontratë shitjeje në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Vlera e deklaruar: 4.761.050 lekë.

Burimi i krijimit: Realizuar nga huadhënia, kjo sipas kontratës noteriale me nr. \*\*\* datë 29.1.2011, e likuiduar ndër vite.

Deklarimi sipas deklaratës periodike për vitin 2011: Nuk është deklaruar burimi i krijimit për këtë pasuri.

<sup>16</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. \*\*\* datë 4.2.2011, me vlerë 4.761.050 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nr. pasurie \*\*\*, Z.K.\*\*\*, sip. ndërtimi 111.5 m<sup>2</sup>. Palë shitëse shoqëria “J” sh.p.k., dhe palë blerëse Dhurata dhe A.H; bashkëngjitur certifikatë pronësie në emër të shitësit dhe hartë treguese.
- Kontratë huaje pa kamatë dhe pa hipotekim, me nr. pasurie \*\*\*, datë 29.1.2011, me vlerë 5.000.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Për një afat kohor deri në marrjen/tërheqjen e një kredie bankare në BKT, në proces. Palë huadhënëse shtetas V. M.V dhe palë huamarrëse shtetasit Dhurata Haveri dhe A. H.

## 2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

**ZVRPP-ja Shkodër**<sup>17</sup> ka konfirmuar pasurinë në bashkëpronësi të shtetasve A dhe Dhurata Haveri.

## 2.2 Burimi i krijimit

Subjekti i rivlerësimit, për këtë pasuri ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se është blerë nga huadhënia marrë nga z. V.V

## 2.3 Analiza e fakteve

Në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, bashkëlidhur kontratës së shitblerjes rezulton një kontratë huaje të hollash (*pa kamatë dhe pa hipotekim pasurie të paluajtshme*), me nr. \*\*\* datë 29.1.2011. Sipas kësaj kontrate huadhënësi do t'i japë hua shumën prej 5.000.000 lekësh shtetasve Dhurata dhe A.H, për një afat kohor deri në marrjen e një kredie në “BKT”.

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar nuk rezultoi që huadhënësi të dispononte si likuiditete në bankë këto shuma dhe në momentin e dhënies së huas të rezultonte pakësimi i tyre.

## 2.4 Hetimi lidhur me burimin e ligjshëm të huas

Subjekti ka pretenduar se z. V.V ka qenë i punësuar pranë subjektit tregtar “Sh” sh.p.k. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2019, lëshuar nga DRT-ja Shkodër, ku deklarohet se nga të dhënat e sistemit *c@ts* të DRT-së Shkodër ky subjekt nuk rezulton të jetë i regjistruar me NIPT, apo me të dhëna të tjera. Bazuar në të dhënat e arkivës ekziston dosja e subjektit “Sh” sh.p.k., me kod fiskal \*\*\* me objekt aktiviteti “rilevime topografike”. Nga të dhënat e kësaj dosjeje rezulton si drejtues teknik, z.V.V

Gjithashtu, subjekti ka bashkëlidhur një dokument me përshkrimin “LICENCE” me nr. \*\*\* lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Komisioni i dhënies së licencave profesionale, dhënë shoqërisë private me emërtim “Sh”, me drejtues teknik, z. V. V dhe drejtues ligjor z. A. T dhe z. N

Bukaqaja.

Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2012, nga ISSH-ja për kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas të cilës deklarohet se për z.V.V janë derdhur rregullisht kontributet për periudhën 1.1.1997 – 31.12.1999.

Komisioni, për nevoja të hetimit, sipas nenit 45/2 të ligjit nr. 84/2016, u ka kërkuar informacion dhe dokumentacion institucioneve publike për të ardhurat nga punësimet e ligjshme të z. V. V, ku vërehet se:

**QKB-ja**<sup>18</sup> dhe **DPT-ja**<sup>19</sup> konfirmojnë se shtetasi V.M.V i datëlindjes 19.10.1955, nuk figuron të jetë pajisur me NIPT si person fizik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrarit tregtar.

**ISSH-ja**<sup>20</sup> konfirmon se shtetasi V.M.V, i datëlindjes 19.10.1955, ka përfiturar të ardhura nga janari i vitit 2012 deri në prill të vitit 2017, nga shoqëria “K” sh.p.k. me NIPT K\*\*\*T dhe nga shoqëria “N \*\*\*” sh.p.k., me NIPT L\*\*\*.

**Bashkia Shkodër**<sup>21</sup> informon se shtetasi V.V nuk rezulton i regjistruar si tatimpagues.

<sup>17</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2018.

<sup>18</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 17.07.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>19</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 26.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>20</sup> Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 10.7.2017 drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>21</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2019.



**DPT-ja**<sup>22</sup> ka informuar se për shtetasin V.V nuk ka të dhëna për aktivitet tregtar të regjistruar. Ky person ka qenë i punësuar te subjekti “K” sh.p.k., si inxhinier gjeolog dhe te subjekti “N.\*\*\*”, si topograf, bashkëlidhur të dhënat për pagesat të cilat i referohen periudhës së siguruar nga dhjetor 2011 – qershor 2019. Këto të dhëna i takojnë një periudhe pasi është dhënë huaja në shumën 5.000.000 lekë, në datën 29.01.2011.

**DRT-ja Shkodër**<sup>23</sup> ka informuar se për z.V.V nuk ka të dhëna për aktivitet tregtar të regjistruar. Ky person ka qenë i punësuar te subjekti “K” sh.p.k., si inxhinier gjeolog dhe te subjekti “N.\*\*\*”, si topograf, bashkëlidhur të dhënat për pagesat.

**DRT-ja Shkodër** nuk disponon informacion lidhur me pagesat e sigurimeve shoqërore për shtetasin V.V, i punësuar si drejtues teknik në shoqërinë “Sh” sh.p.k., me kod fiskal \*\*\*

Z.V.V nuk ka në emër të tij leje ushtrimi profesioni privat në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër.

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës Shkodër**<sup>24</sup> ka depozituar informacion për të ardhurat e përfituara nga z.V.V, për periudhën e punësimit në këtë institucion 2003 – 2009. Nga këto të dhëna rezulton se z.V.V ka përfituar shumën 1.231.336 lekë.

Nga i gjithë historiku i punësimit të z.V.V i vetmi informacion zyrtar që u administrua nga Komisioni ishte përgjigja e ASHK-së Shkodër.

Komisioni analizoi mundësinë financiare për kursime të z. V.V, sipas tabelës vijuese.

Vitet	6.6.2003	2004	2005	2006	2007	2008	16.4.2009	Total
Të ardhurat	109 359	198 483	213 496	350 392	500 787	511 134	164 587	2 048 238
Shpenzimet	93 964	93 964	109 557	109 557	136 620	136 620	39 676	719 958
Mundësia për kursime	15 395	104 519	103 939	240 835	364 167	374 514	124 911	1 328 280

Në vlerësimin financiar që i është bërë z.V.V shpenzimet vjetore janë llogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së për një person.

Subjekti, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, në përgjigjet e pyetësorit<sup>25</sup> ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 15.8.2019, të lëshuar nga “R. B”, ku saktësohet se z.V.V ka pasur një depozitë me të dhënat vijuese:

- çelur në vitin 1997 dhe mbyllur më 23.10.2002 – nuk ka të dhëna për shumën në fund të periudhës.
- shuma e depozitës më 31.12.1999 është në vlerën 1.905.406 lekë dhe më 31.12.2000 është në vlerën 3.511.505 lekë.

Kjo depozitë i referohet të ardhurave të z.V.V para vitit 1997 – periudhë në të cilën nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni nuk u vërtetua se ka qenë i siguruar si i punësuar apo i vetëpunësuar në ndonjë subjekt shtetëror apo privat.

## 2.5 Analiza e fakteve

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosje dhe të analizës së mësipërme, ka rezultuar se:

- dokumentacioni i disponuar nuk provon se z.V.V ka pasur në datën 29.1.2011 shumën prej 5.000.000 lekësh, datë kur është dhënë huaja;

<sup>22</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2019.

<sup>23</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 14.8.2019.

<sup>24</sup> Me shkresën e datës 9.9.2019.

<sup>25</sup> Pytësorin e datës 3.8.2019.

- nga subjektit nuk u provua se z.V.V ka pasur burime të ligjshme në shumën 5.000.000 lekë.
  - Deri më 31.12.1999, z.V.V, ka pasur një depozitë në Bankën e Kursimeve (sot Raiffeisen Bank) në shumën prej 1.905.406 lekësh dhe më datë 31.12.2000 është në shumën prej 3.511.505 lekësh, por nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ nuk u provua se z.V.V. ka qenë i siguar si punonjës, për t'i konsideruar këto të ardhura të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- Nga dokumentacioni i depozituar në dosje nuk u arrit të provohej burimi i ligjshëm i krijimit të shumës së dhënë hua nga z.V.V. Për pasojë kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare të subjektit, si burim i ligjshëm i krijimit të pasurisë.

	Përshkrimi	2006	2009	2011
	<b>Pasuri</b>	<b>812 196</b>	<b>2 693 002</b>	<b>1 273 950</b>
	Ap. me sip. 115 m <sup>2</sup> blerë në shkurt 2011 në Shkodër	618 515	2 057 550	2 084 985
	Ndryshim i likuiditetit	193 681	635 452	-811 035
	<b>Detyrime</b>	<b>-125 003</b>	<b>-422 851</b>	<b>-656 666</b>
	Detyrim për kredinë në NBG (6.000 €)	-125 003	-197 733	-
	Detyrim ndaj R L (Citroen)	-	-225 118	-656 666
1	<b>Pasuri neto (Pasuri - Detyrime)</b>	<b>937 199</b>	<b>3 115 853</b>	<b>1 930 617</b>
2	<b>Të ardhura</b>	<b>1 393 890</b>	<b>2 193 809</b>	<b>2 331 854</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	1 377 150	1 713 737	1 794 948
	Të ardhura bashkëshorti (aktiviteti privat)	16 740	480 072	536 906
3	<b>Shpenzime</b>	<b>594 873</b>	<b>819 455</b>	<b>886 138</b>
	Shpenzime jetike sipas standardit të ILDKPKI-së	438 228	546 480	546 480
	Shpenzime udhëtimi	83 975	103 247	203 902
	Shpenzim për interesa bankare të kredisë në "NBG"	72 670	21 459	0
	Shpenzime interesa R L	0	148 268	135 757
	<b>Rezultati (2-3-1)</b>	<b>-138 182</b>	<b>-1 741 499</b>	<b>-484 901</b>

## 2.6 Shlyerja e huas nga subjekti i rivlerësimit

Subjektit, në pyetësorin e datës 22.4.2019 iu kërkua të japë informacion dhe dokumentacion se si është shlyer kjo hua, duke specifikuar vitet dhe shumat respektive të kthimit të huas. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se: *Likuidimi i kësaj huaje ndaj huadhënësit z. V. V (që është kunati i subjektit) është bërë nga njëri vit në tjetrin, sipas deklarimeve të bëra nga ana e saj në deklaratat e pasurive ndër vite, referuar mundësive të tyre paguese dhe gjendur në kushtet mirëbesimi midis palëve.*

Nga verifikimi i deklaratës “Vetting” evidentohet detyrimi i mbetur ndaj huadhënësit në shumën 900.000 lekë, i padeklaruar.

## **2.7 Analiza financiare për periudhën 2006 – 2011<sup>26</sup>**

Komisioni kreu analizën financiare për këtë periudhë për të verifikuar mundësinë financiare mbi pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në Shkodër.

Subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti për këtë arsye nuk janë përfshirë në analizën financiare.

- Nga analiza e kryer nga Komisioni për periudhën 2006 –2011, rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare në shumën – **2.364.582 lekë**, për të krijuar pasurinë e mësipërme dhe për të përballuar shpenzimet. Lidhur me këtë konstatim subjektit iu kalua barra e provës.

## **2.8 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

**2.8.1** Subjekti, përveç pretendimeve të paraqitura në pikën 1.5, të sipërtrajtuara për të ardhurat e huadhënësit, ka vijuar me pretendimin se:

- Me hyrjen në fuqi të ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në vitin 1993, u ngrit Njësia e Menaxhimit për Projektin e Pasurive të Paluajtshme (NMP), financuar nga USAID, Banka Botërore dhe Bashkimi Europian. Në vitin 1994 kanë filluar përgatitjet e hartave sipas ligjit në fuqi. Në vitin 1994 deri në vitin 1996, z. V.V, ka qenë i punësuar sipas kontratave të porosisë nga NMP-ja Tiranë si individ për përgatitjen e hartave treguese.
- Pas kësaj periudhe, subjekti ka pretenduar se z. V.V, ka qenë i angazhuar në shoqërinë “Sh” sh.p.k., me punime topogjeodezike, e cila ka qenë e kontraktuar për përgatitjen e hartave treguese për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme për Projektin N.M.P për S.R.P.P Laprakë, financuar nga USAID, Banka Botërore dhe Bashkimi Europian nëpërmjet kontratave të porosisë apo procedurave të tenderimit.
- Subjekti argumentoi se i gjithë dokumentacioni (kontratat e porosisë të tenderave, etj.) ndodhet në NMP-në Tiranë, sot Zyra Regjistrimit Pasurive të Paluajtshme dhe se këto pretendime janë parashtruar edhe në seancë dëgjimore, prandaj dhe hetimi i kryer përgjatë kësaj periudhe, duhej të ishte përqendruar edhe në rrethanat e mësipërme të parashtruar prej saj, duke iu drejtuar organeve publike dhe private, për marrjen e informacionit lidhur me kryerjen e punimeve të mësipërme nga z. V.V, punime që përkthehen në të ardhura të akumuluar përgjatë viteve, dhe që vërtetojnë plotësisht burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij.
- Subjekti ka pretenduar se Komisioni është treguar paragjykes dhe dukshëm i njëanshëm, pasi në mënyrë të qëllimshme, jo vetëm nuk ka marrë parasysh faktet e parashtruara për të ardhurat e krijuara nga z. V. V të cilat rezultojnë më të larta nga ato që rezultojnë të vërtetuara, por edhe të ardhurat që rezultojnë të vërtetuara me dokumentacionin përkatës se janë realizuar nga ana jonë. Përfundim i cili rezulton qartazi në konkluzionet që Komisioni ka parashtruar në lidhje me huan e marrë nga z. V.V.

## **2.9 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave**

**2.9.1** Pretendimet për sa më sipër të subjektit janë të pabazuara në ligj. Komisioni argumenton se në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet: “*Subjekti i*

<sup>26</sup> Periudha kur janë kryer pagesat për blerjen e pasurisë apartament.

*rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*". Sipas këtij përcaktimi ishte detyrim i subjektit që të provonte burimet e ligjshme të huadhënësit.

Nga dokumentacioni i administruar nga hetimi shtesë rezultoi se huadhënësi ka qenë i punësuar në ZVRPP-në Shkodër. Për këtë periudhë ka pasur si burime të ligjshme shumën 1.328.280 lekë.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ky ishte i vetmi informacion zyrtar që u administrua. Nëse subjekti ka disponuar informacione dhe dokumentacione shtesë, kishte barrën e provës që të provonte burimet e ligjshme të huadhënësit dhe për pasojë duhet ti kishte depozituar në cilësinë e provës për të mbështetur pretendimet e saj.

**2.9.2** Për sa ka deklaruar subjekti se z. V.V ka qenë i angazhuar pranë shoqërisë "Sh" sh.p.k., dhe kanë marrë përsipër projekte me procedura tenderimi apo Kontrata Porosie, nuk e mbështeti këtë pretendim në ndonjë provë.

**2.9.3** Në lidhje me provat që ka depozituar subjekti të dhënat bankare sipas vërtetimit të R. B janë indice për të ardhura të z. V. V, por nuk provojnë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës se dhënë hua.

Komisioni, nga analiza sa më sipër, vlerëson se subjekti nuk depozitoi asnjë provë për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me burimet e ligjshme të huadhënësit.

- Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi për këtë pasuri, trupi gjyqës çmon se, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germën "b", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**3. Apartament<sup>27</sup>**, me sip. ndërtimi 95 + 14.3 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët blerë në vitin 2015, me nr. \* shk. \*, godinë banimi \* kate me nënçati, me nr. \*, në Komunën F.

Në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Vlera e deklaruar: 60.000 euro.

Burimi i krijimit: Realizuar me të ardhurat nga puna dhe kredi bankare, sipas kontratës me nr. \*\*\*, datë **23.12.2013**, kredidhënës "BKT" (kredi në proces në masën 5.000.000 lekë) + detyrim i prapambetur shoqërisë "A" sh.p.k. Detyrim i palikuiduar sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 4.5.2015, dhe deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 21.5.2015 (pasuria me nr. \*\*\*).

### **3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**ZVRPP-ja Tiranë<sup>28</sup>** ka konfirmuar pasurinë apartament në bashkëpronësi të bashkëshortëve.

### **3.2 Analiza e provave**

<sup>27</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën:

- Kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. \*\*\*, datë 4.5.2015, me vlerë 60.000 euro, e likuiduar para lidhjes së kontratës, me anë të kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 15.5.2013. Palët deklarojnë se nuk kanë pretendime për çmimin dhe mënyrën e pagesës. Nr. pasurie \*\*\*, Z.K. \*\*\*, sip. ndërtimi 95 m<sup>2</sup> me sipërfaqe të përbashkët 14.3 m<sup>2</sup> dhe 50% e verandës 24 m<sup>2</sup>. Sipërfaqe e përgjithshme 133.3 m<sup>2</sup>. Palë shitëse shoqëria "A" sh.p.k., dhe palë blerëse Dhurata Haveri. Bashkëngjitur certifikatë pronësie në emër të shitësit, kopje kartelev, planimetri.

Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 21.5.2015, me palë deklaruese shoqërinë "A" sh.p.k., e cila deklaroi se për rrjedhojë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 4.5.2015, i cakton blerësit në këtë kontratë, konkretisht subjektit, një afat shtesë prej 5 vjetësh, për të shlyer detyrimin prej 19.000 euro.

<sup>28</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2019.

Nga analizimi i provave ka rezultuar se subjekti ka nënshkruar një kontratë porosie, nr. \*\*\*, datë 15.5.2013, me shoqërinë sipërmarrëse “A” sh.p.k., për porositjen e një apartamenti në zonën e Farkës. Në nenin 3, të kontratës me përshkrimin “*mënyra e pagesës*” është parashikuar: “*Vlera e apartamentit është 60.000 euro. Me lidhjen e kontratës do paguhet 15.000 euro; kësti i dytë është 35.000 euro; kësti i tretë 10.000 euro*”.

Sipas kartelës së pasurisë, depozituar nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>29</sup>, rezulton se pronësia e kësaj pasurie ka kaluar në emër të subjektit në datën 13.5.2015.

Në dosjen e ILDKPKI-së rezulton një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 21.5.2015, lëshuar nga shoqëria “A” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori L.Gj. Sipas kësaj deklarate shoqëria “A” sh.p.k., si palë shitëse në kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 4.5.2015, i cakton blerësit në këtë kontratë, një afat shtesë prej 5 (pesë) vjetësh, për shlyerjen e detyrimeve të mbetura pa paguar, nga çmimi i shitjes në kontratë si më sipër. Ky detyrim është në shumën prej 19.000 euro dhe do të paguhet nga blerësi brenda afatit të mësipërm.

Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Komisioni, shoqëria “A” sh.p.k., ka konfirmuar se: “*Për detyrimin prej 19.000 euro, deri në datën 3.5.2019, blerësi nuk ka bërë asnjë pagesë për shlyerje detyrimi*”.

### **3.3 Burimi i krijimit të kësaj pasurie**

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga puna + kredi bankare në Bankën Kombëtare Tregtare.

Komisioni i ka kërkuar subjektit:

- *Të depozitojë mandatarkëtimet për pagesat e kryera pranë shoqërisë ndërtuese.*
- *Të deklarojë kohën kur është kryer mobilimi i këtij apartamenti, si dhe sa ka qenë vlera e këtij mobilimi.*
- *Për detyrimin e mbetur pashlyer prej 19.000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* datë 21.05.2015, të saktësojë sa është vlera e shlyer për çdo vit e këtij detyrimi, deri më tani.*

Subjekti ka shpjeguar se: “*Në lidhje me apartamentin e blerë në F., në vitin 2013, me sip. 95m<sup>2</sup>+14.3 m<sup>2</sup>, i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 15.5.2013, parashtraj se:*

*a- Shuma kredisë bankare në masën 5.000.000 (pesë milion) lekë, me kontratën nr. \*\*\*, i është kaluar nëpërmjet “BKT”-së, dega në Rr. “A. F”, firmës ndërtuese “A” sh.p.k., kredi e cila vazhdon të jetë në proces likuidimi prej saj.*

*b- Deri në këto momente nuk është shlyer asnjë pjesë nga detyrimi i parashikuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 21.5.2015, nga unë, Dhurata Haveri, pra, vazhdon si detyrim në gjendje të palikuiduar.*

*c- Diferenca, një vlerë e vogël është paguar nga ana ime, kjo në zbatim të kontratës së porosisë, me nr. \*\*\*, datë 15.5.2013, në shumën rreth 65.000 (gjashtë dhjetë e pesë mijë) lekë, cash, pas lëvrimit të kredisë për objektin, apartament në Farkë (bashkëlidhur kontrata e porosisë nr. \*\*\*, datë 15.5.20 13).*

*c- Në këtë apartament deklaroj se nuk është bërë asnjë mobilim dhe në të, nuk jeton njeri.”*

Komisioni vlerëson se referuar kontratës së porosisë nr. \*\*\* datë 15.5.2013, është parashikuar se me lidhjen e kontratës blerësit do paguanin shumën prej 15.000 euro. Ky parashikim nuk përputhet me deklarinimin e subjektit në pyetësor kur shpjegon se ka parapaguar shumën prej 65.000 lekësh.

<sup>29</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2018.

Referuar kontratës së kredisë me bankën thuhet se: “Shuma e kredisë prej 5.000.000 lekësh do të përdoret për likuidimin e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në llogarinë e shitësit të objektit të kredituar shoqërisë “A” sh.p.k., me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.” Nga ky parashikim rezulton se subjekti kredinë e ka përdorur për të shlyer pjesën e mbetur të pagesës, ndërkohë që subjekti duhet të ketë paguar një pjesë të çmimit të apartamentit paraprakisht. Referuar dokumentacionit bankar rezulton se sipas lëvizjeve të llogarisë, datë 30.05.2014, në BKT, znj. Dhurata Haveri transferon shumën prej 4.924.312 lekësh në llogarinë e shoqërisë “A” sh.p.k., me përshkrimin: “Kalim i këstit të fundit për blerjen e apartamentit”.

Ndërkohë që kontrata e kredisë bankare me nr. \*\*\*, me BKT-në, është nënshkruar më datë 23.12.2013, pagesa e këstit të parë për blerjen e kësaj pasurie në shumën 15.000 euro, sipas kontratës së porosisë të datës 15.5.2013, duhej të kryhej me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Nga analizimi i akteve vërehet se është e paqartë situata në lidhje me çmimin e paguar sepse rezultojnë tre kontrata (e sipërmarrjes 2013/; e kredisë bankare 2014/; dhe e shitblerjes 2015), të cilat tregojnë se shuma e paguar deri në maj të vitit 2015 është 60.000 euro. Deklarata noteriale për detyrimin në shumën 19.000 euro është nënshkruar pas kontratës së shitblerjes dhe pasi prona është regjistruar në ZVRPP e ka kaluar në emër të subjektit.

- Nga analiza e fakteve ngrihen dyshime mbi shumën e paguar nga blerësi si kësti i parë në blerjen e apartamentit sepse deklaratimet e subjektit nuk përputhen me kontratën e porosisë.

### 3.4 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2014 – 2015<sup>30</sup>, për të verifikuar mundësinë financiare mbi pagesat e kryera. Në analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara sipas të dhënave bankare dhe dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucionet përkatëse për të ardhurat e të dy bashkëshortëve.

	<b>Pasuri</b>	<b>9 664 345</b>	<b>-1 216 618</b>
	Apartament në F me kontratë sipërmarrje më 15.5.2013	8 406 600	0
	Garazh me sip. 14 m <sup>2</sup>	700 550	0
	Ndryshim i likuiditetit	557 195	-1 216 618
	<b>Detyrime</b>	<b>8 362 640</b>	<b>-990 774</b>
	Kredi “BKT” 5.000.000 lekë	5 000 000	-302 524
	Detyrim ndaj kompanisë së ndërtimit "A"	3 362 640	-688 250
1	<b>Pasuri neto (Pasuri - Detyrime)</b>	<b>1 301 705</b>	<b>-225 844</b>
2	<b>Të ardhura</b>	<b>2 127 490</b>	<b>2 021 791</b>
	Të ardhura nga paga e subjektit	1 759 815	1 745 044

<sup>30</sup> Periudhë në të cilën janë shlyer detyrimet për blerjen e pasurisë.

	Të ardhura bashkëshorti (aktiviteti privat)	367 675	135 347
	Të ardhura bashkëshorti / vendim gjykate-Justitia		141 400
	Të ardhura bashkëshorti / Universiteti “A. M “		-
3	<b>Shpenzime</b>	<b>2 495 823</b>	<b>2 571 504</b>
	Shpenzime jetike të deklaruara	900 000	448 552
	Shpenzime udhëtimi	616 781	456 843
	Paguar interesa bankare të kredisë në BKT	320146,84	275029
	Shpenzime kredie	75 688	-
	Shpenzime shkollimi	583 208	1 391 080
	<b>Rezultati (2-3-1)</b>	<b>-1 670 039</b>	<b>-323 869</b>

Në analizën financiare janë përfshirë, sa vijon:

- Vlera e pronës prej 60.000 euro është paguar nëpërmjet:
  - kredisë bankare 5.000.000 lekë *disbursuar* dhe kaluar direkt në llogarinë e shitësit në maj të vitit 2014 nga “BKT”-ja;
  - detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit në fund të vitit 2014 është 24.000 euro (deklaruar në DPV-në e vitit 2014);
  - detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit në fund të vitit 2015 është 19.000 euro (deklaratë noteriale më 21.5.2015), pra, shuma 5.000 euro është paguar gjatë vitit 2015. Detyrimi i mësipërm vazhdon të jetë edhe sot.
- Megjithëse subjekti nuk i saktësoi asnjëherë shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, Komisioni, ka përfshirë shpenzimet e shkollimit, sipas dokumenteve të:
  - N. Y.U, për vajzën në vitin 2014;
  - nga lëvizjet e llogarisë së E. H në “I. S. B” në vitin 2015 (shuma 7.200 euro);
  - shuma 400.000 lekë e deklaruar si “shpenzime shkollimi” në DPV-në e vitit 2015.
- Shpenzimet e jetesës:
  - për vitin 2014 janë konsideruar sikurse janë deklaruar nga vetë subjekti në DPV-në e vitit përkatës;
  - për vitin 2015, p sipas standardit të ILDKPKI-së për dy persona, pasi të dy fëmijët studiojnë jashtë Shqipërisë.
- Gjendja *cash* sikurse e trajtuar më sipër.

Nga analiza financiare, rezultati negativ në vitin 2014 – 2015 krijohet për shkak të shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve, pagesat e kredive dhe shpenzimet e udhëtimit, etj.

- Për sa më sipër, u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare në shumën - **1.993.907 lekë**.

Subjektit, për të dyja faktet e mësipërme, i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

### 3.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet nga Komisioni

**3.5.1** Prapësimet e subjektit për konstatimet e Komisionit janë referuar në pikën 1.5, sipërtrajtuar.

### **3.6 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave**

**3.6.1** Subjekti nuk ka depozituar prova për të mbështetur pretendimet e saj. Në lidhje me kundërshtimet që ka pasur subjekti për analizën financiare, Komisioni ka parashtruar argumentet për këtë çështje në pikën 1.6 të këtij vendimi.

- Trupi gjykue, për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi për këtë pasuri, çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germën b, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**4. Garazh<sup>31</sup>**, me sip. 14 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, datë 4.5.2015, Farkë, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Vlera e deklaruar: 5.000 euro.

Burimi i krijimit: Realizuar me të ardhurat nga puna e të dy bashkëshortëve.

#### **4.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**ZVRPP-ja Tiranë<sup>32</sup>** konfirmon se në emër të subjektit është regjistruar pasuria “garazh” me sip. 14 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\* Z.K \*\*\* me çmim blerjeje 5.000 euro.

#### **4.2 Analiza financiare**

Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e garazhit, referuar tabelës së mësipërme

Në fund të vitit 2013 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 900.000 lekë dhe gjatë muajit prill 2014 ka paguar garazhin me tre këste. Potencialisht subjekti ka pasur pjesërisht mundësi të mbulojë pagesat për garazhin.

Viti 2013 rezulton me balancë negative prej -271.767 lekësh dhe vetëm 628.233 lekë mund të justifikohen me burime të ligjshme të ardhurash.

Gjatë vitit 2014 subjekti rezulton në pamundësi financiare për të mbuluar të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e shkollimit për vajzën, të udhëtimeve, pagesat e kredive, të jetesës etj.

- Për sa më sipër, u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare në shumën **-1.670.039 lekë**.

#### **4.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet nga Komisioni**

**4.3.1** Prapësimet e subjektit për konstatimet e Komisionit janë referuar në pikën 1.5 të sipërtrajtuara.

### **4.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave**

**4.4.1** Subjekti nuk ka depozituar prova për të mbështetur pretendimet e saj. Në lidhje me kundërshtimet që ka pasur subjekti për analizën financiare, Komisioni ka parashtruar argumentet për këtë çështje në pikën 1.6 të këtij vendimi.

<sup>31</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerjeje garazhi nr. \*\*\*, datë 4.5.2015, me vlerë 5.000 euro, e likuiduar para lidhjes së kontratës, sipas mandat pagesave bashkëngjitur kontratës. Nr. pasurie \*\*\*, Z.K. \*\*\*, sip. 14 m<sup>2</sup>. Palë shitëse shoqëria “A” sh.p.k., dhe palë blerëse Dhurata Haveri; bashkëngjitur certifikatë pronësie në emër të shitësit, kopje kartelev, planimetri.

<sup>32</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2019.



- Trupi gjykues, për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi për këtë pasuri, çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germën b, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## 5. Automjet “C. C”<sup>33</sup>, viti i krijimit 2008, në pronësi të subjektit.

Vlera e deklaruar: 19.000 euro.

Burimi i krijimit: Blerë me kredi, në shoqërinë R. L, me kontratën nr. \*\*\*, dhe nr. 1143, datë 20.4.2008; kohë fillimi më 11.5.2008; vlera e financimit 10.999 euro; paradhënie 8.000 euro; dhe nga të ardhurat nga paga + shitja e mjetit sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 27.9.2008, notere A.A.

### 5.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

**RL**<sup>34</sup> konfirmon marrëdhënien e qirasë financiare të subjektit sipas kontratës nr. \*\*\*, e mbyllur më datë 4.02.2011.

**DPSHTRR-ja**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2018, konfirmon automjetin me targë TR \*\*\*P, në pronësi të shtetasës Dhurata Haverit, sipas kontratës së shitblerjes të datës 29.4.2011 lidhur ndërmjet subjektit dhe shoqërisë R. L.

### 5.2 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2007 – 2011, kohë në të cilën janë kryer pagesat nga subjekti për blerjen e autoveturës dhe pagesën e detyrimit ndaj R. L.

Nga dokumentacioni i disponuar në dosjen e subjektit vihet re se është kryer pagesë në shumën 8.000 euro (*konvertuar në 985.460 lekë*<sup>35</sup>) në prill 2008, ku burimi deklarohet nga të ardhurat nga shitja e mjetit në shumën prej 100.000 lekësh dhe pjesa tjetër (*e konvertuar në lekë në shumën e 885.460 lekë*) nga të ardhurat nga pagat.

Referuar burimit të krijimit të deklaruar:

- nga kursimet: një vit më parë, në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 1.500.000 lekë/12.406 euro. Por në vitin 2007, subjekti ka qenë në pamundësi për të krijuar këto kursime në *cash* (shih tabelën – analizën financiare 2007 – 2008);
- nga pagat e të dy bashkëshortëve – të vetmet të ardhura deri në muajin prill janë rreth 557.000 lekë, pa zbritur këtu shpenzimet apo pagesa të tjera;
- gjithashtu, automjeti është shitur në datën 27.9.2008, pra, pas pagesës së shumës 8.000 euro të parapaguar te R L.

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011
<b>Pasuri</b>	<b>1 373 931</b>	<b>668 110</b>	<b>2 693 002</b>	<b>450 612</b>	<b>1 273 950</b>
Ap. me sip. 115 m <sup>2</sup> blerë në shkurt 2011 në Shkodër			2 057 550	0	2 084 985

<sup>33</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Faturë tatimore shitjeje nr. \*\*\*, datë 4.2.2011, për automjetin tip “C.P”, me targa TR \*\*\* P, në shumën 5.509,21 euro, e konvertuar në shumën 768.211 lekë. Palë shitëse “R. L” sh.a., dhe palë blerëse subjekti.
- Certifikatë pronësie mjetit rrugor nr. \*\*\*, datë 5.1.2012, për automjetin e sipërcituar.
- Plani i pagesave nga “R. L”, për qiranë e marrë nga subjekti me objekt qiraje automjetin tip “C 4”, me datë fillimi 11.5.2008 dhe datë mbarimi 11.4.2013. Çmimi i blerjes 19.000 euro, paradhënie 8.000,01 euro, vlera e financimit 10.999,99 euro.

Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme, automjet tip “D. B”, me targë SH \*\*\* D, nr. \*\*\*, datë 27.9.2008, me vlerë 100.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Palë shitëse shtetasit A. H dhe palë blerëse shtetasi A.D

<sup>34</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2018.

<sup>35</sup> Me kursin e këmbimit euro/lekë 1: 123,18 sipas Bankës së Shqipërisë.

	Autoveturë me <i>leasing</i>		2 340 468			
	<i>Ndryshim i likuiditetit</i>	1 373 931	-1 672 357	635 452	450 612	-811 035
	<b>Detyrime</b>	<b>-137 540</b>	<b>1 078 455</b>	<b>-422 851</b>	<b>-323 741</b>	<b>-656 666</b>
	Detyrim për kredinë në NBG (6.000 euro)	-137 540	-157 741	-197 733	-72 098	0
	<i>Detyrim ndaj R L (C)</i>		<i>1 236 196</i>	<i>-225 118</i>	<i>-251 643</i>	<i>-656 666</i>
<b>1</b>	<b>Pasuri neto (Pasuri - Detyrime)</b>	<b>1 511 472</b>	<b>-410 345</b>	<b>3 115 853</b>	<b>774 353</b>	<b>1 930 617</b>
<b>2</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>1 446 437</b>	<b>1 770 382</b>	<b>2 193 809</b>	<b>2 173 993</b>	<b>2 331 854</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	1 427 537	1 327 500	1 713 737	1 631 951	1 794 948
	Të ardhura bashkëshorti (aktiviteti privat)	18 900	342 882	480 072	542 042	536 906
	Të ardhura nga shitja e makinës		100 000			
<b>3</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>841 652</b>	<b>825 555</b>	<b>819 455</b>	<b>939 251</b>	<b>886 138</b>
	Shpenzime jetike të deklaruara	546 480	546 480	546 480	546 480	546 480
	Shpenzime udhëtimi	239 502	125 988	103 247	274 437	203 902
	Shpenzim për interesa bankare të kredisë në NBG	55 670	39 101	21 459	1 797	0
	Shpenzime interesa R L	0	113 986	148 268	116 537	135 757
	<b>Rezultati (2-3-1)</b>	<b>-906 686</b>	<b>1 355 172</b>	<b>-1 741 499</b>	<b>460 389</b>	<b>-484 901</b>

Në tabelë janë analizuar vitet 2008 deri 2011, periudhë në të cilën shlyhet detyrimi ndaj shoqërisë R. L.

Referuar analizës së vitit 2007, duket se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme akumulimin e kursimeve *cash* në shumën prej - 906.686 lekësh , si rrjedhim, edhe në momentin e pagesës së shumës fillestare prej 8.000 euro, subjekti nuk e justifikon shumën e paguar me burime të ligjshme.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitet 2007 – 2011, duket se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të krijuar pasuritë dhe për të paguar shpenzime sipas viteve të analizuar.

- Komisioni vëren se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të kryer pagesat përkatëse për këtë pasuri (parapagimi dhe pagesat e kësteve).

### 5.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet

5.3.1 Prapësimet e subjektit për konstatimet e Komisionit janë referuar në pikën 1.5, të sipërtrajtuar.

### 5.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

5.4.1 Subjekti nuk ka depozituar prova për të mbështetur pretendimet e saj. Në lidhje me kundërshtimet që ka pasur subjekti për analizën financiare, Komisioni ka parashtruar argumentet për këtë çështje në pikën 1.6 të këtij vendimi.

- Trupi gjykues, për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi për këtë pasuri, çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germen “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## 6. Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti privat

## 6.1 Deklarimi i të ardhurave<sup>36</sup>

- Të ardhura nga paga si regjisor në teatrin “M” Shkodër për periudhën 25.10.1991 – 1.1.1994, nuk gjenden në arkiv. Të ardhura nga paga si regjisor në teatrin “M” Shkodër, për periudhën 1.1.1994 – 31.12.2003, referuar vërtetimit nr. \*\*\*prot., datë 25.1.2017, lëshuar nga Drejtoria Ekonomike e Kulturës Shkodër. Paga bruto është në shumën 877.010 lekë.
- Të ardhura nga paga si regjisor në Radiotelevizionin Shqiptar, Drejtoria e Programit Satelitor, për periudhën prill 2008 deri më korrik 2010, referuar vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare. Sipas vërtetimit nr. \*\*\*prot., datë 25.1.2017, pasqyrohen të ardhurat neto nga puna si regjisor, Drejtoria e Programeve Satelitore në masën: 1.042.483 lekë dhe 794.686 lekë.
- Të ardhura nga puna si avokat, me licence nr. \*\*\*, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, nga viti 2003 – 2009; shuma neto 1.600.000 lekë.
- Të ardhura nga puna për shkak të ushtrimit të profesionit të noterit, sipas Urdhrit nr. \*\*\*, datë 22.4.2011, të Ministrit të Drejtësisë; subjekt i tatimeve me NIPT L\*\*\*A adresa: Rr. “F.P”, Tiranë; të ardhura të deklaruara në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Tiranë, kërkesa për marrjen e të cilave nuk është ekzekutuar.

## 6.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

**QKB-ja**<sup>37</sup> konfirmon se z. A. H figuron i regjistruar si person fizik në datën 21.11.2011, dhe është pajisur me NIPT L\*\*\*\*A.

**DRT-ja Tiranë**<sup>38</sup> konfirmon se z. A. H është administrator i personit fizik “A.H” me NIPT L\*\*\*A. Sipas të dhënave të sistemit *C@TS* është regjistruar në datën 21.11.2011, me aktivitet “aktivitete juridike”, dhe ka detyrime tatimore të padërguara në shumën 82.160 lekë deri më datën 26.1.2017. Për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 tatimpaguesi ka deklaruar qarkullim në shumën totale 3.236.726 lekë dhe fitim në shumën totale 1.324.732 lekë. Tatimpaguesi nuk shpërndan *divident*.

Z. A. H është administrator i subjektit “A. H” me NIPT L\*\*\*B. Sipas të dhënave të sistemit *C@TS* është regjistruar në datën 23.8.2011 me aktivitet “aktivitete juridike”. Subjekti ka detyrime tatimore në shumën 20.000 lekë dhe ka deklarata të padërguara. Subjekti paraqitet me status pasiv prej datës 24.12.2014. Subjekti nuk ka deklaruar të ardhura.

**Bashkia Tiranë**<sup>39</sup> konfirmon se subjekti “A.H” me NIPT L\*\*\*A, me aktivitet noter, është regjistruar si biznes i vogël në datën 21.11.2011 dhe është me status aktiv. Subjekti ka likuiduar detyrimet dhe ka pasur një qarkullim vjetor: për vitin 2011 në nivelin 0 - 2 milionë lekë; për vitin 2012 - 2013 në nivelin 3 - 4 milionë lekë; për vitet 2014 e në vazhdim pranë këtij institucioni subjekti likuidon vetëm tarifatat vendore. Subjekti “A.H” me NIPT L\*\*\*B, është regjistruar në sistemin e Drejtorisë Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore në datën 23.8.2011 dhe ka aplikuar pranë QKB-së për mbyllje aktiviteti në datën 22.9.2011, dhe gjatë kësaj periudhe ka likuiduar detyrimet me nivel qarkullimi 0-2 milionë lekë. Për sa i përket fitimit të realizuar në vite nuk është kompetencë e kësaj drejtorie.

<sup>36</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nr. \*\* prot., datë 25.1.2017, nga Bashkia Shkodër ku konfirmohet se shtetasi A. H figuron në borderotë e degës ekonomike të kulturës nga janari i vitit 1994, kohë kur teatri “M” ishte pjesë e kësaj dege. Bashkëngjitur tabelën analitike ku konfirmohen të ardhurat bruto të përfituara nga bashkëshorti i subjektit për periudhën nga janari i vitit 1994 deri në qershor të vitit 2003, në shumën totale rreth 876.302 lekë.

<sup>37</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2018.

<sup>38</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>39</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 30.6.2017, drejtuar ILDKPKI-së

**DRT-ja Tiranë**<sup>40</sup> konfirmon se shtetasi A. H rezulton i regjistruar në organin tatimor me status “person fizik” me NIPT L\*\*\*A, me aktivitet “aktivitete juridike”. Nga verifikimi në sistemin C@ts rezulton se ka përfituara të ardhura bruto nga dhjetori i vitit 2011 deri në janar të vitit 2017 në shumën totale 667.282 lekë. Për periudhën 2015 – 2017 rezulton se ka paguar vetëm kontributet.

**ISSH-ja**<sup>41</sup>, konfirmon se shtetasi A. H përfiton të ardhura nga personi fizik “A. H” me NIPT L\*\*\*A dhe nga Universiteti “A. M” nga janari i vitit 2012 deri në mars të vitit 2017.

### 6.3 Analiza financiare

#### 6.3.1 Në lidhje me të ardhurat nga avokatia e bashkëshortit të subjektit

Sipas deklaratës periodike për vitet 2003 – 2009, është deklaruar se janë përfituar të ardhura në shumën prej 4.020.000 lekësh nga bashkëshorti në ushtrimi i profesionit të avokatit, si më poshtë:

Të ardhura të deklaruara në DPV-të	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Të ardhura si avokat me licence 2003 – 2009		120 000	500 000	1 800 000	1 600 000		

- Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron të ardhura nga ushtrimi i profesionit të avokatit në shumën totale prej 1.600.000 lekësh.
- Në informacionin e marrë në formë zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk rezulton që shtetasi A.H të ketë qenë i regjistruar si tatimpagues në këtë periudhë, si avokat.
- Subjekti, në përgjigje të pyetësorit dërguar Komisionit deklaron se bashkëshorti i saj ka punuar si avokat me licencë pranë studios ligjore të avokatit S.V.

Komisioni i ka kërkuar informacion “Studios ligjore” të avokatit S.V, disa herë për të provuar deklaratimet e subjektit lidhur me të ardhurat e përfituara nga avokatia në periudhën 2003 – 2009, si dhe për pagën bruto/neto dhe kontributet e paguara për këtë periudhë. Kjo zyrë ligjore nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Komisionit.

#### Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për periudhën 2003 – 2011

Nga informacionet e marra në formë zyrtare mbi punësimin dhe pagesat e përfituara të z. A. H, për periudhën 2003 – 2011, shuma totale e të ardhurave është 2.026.150 lekë, e detajuar në tabelën më poshtë:

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Të ardhura si regjisor pranë teatrit “M” Shkodër Vërtetim nr** prot., datë 24.01.2017	88 608								
Të ardhura me bankë (Soc. Gen) nga Akademia e Arteve				16 740	18 900	21 250	22 400		
Të ardhura me bankë (U. B) RTSH, regjisor						321 632	457 672	542 042	536 906
<b>Total</b>	<b>88 608</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>16 740</b>	<b>18 900</b>	<b>342 882</b>	<b>480 072</b>	<b>542 042</b>	<b>536 906</b>

<sup>40</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>41</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

Nga deklaratat periodike të subjektit në lidhje me të ardhurat e z. A. H për periudhën 2003 – 2011, jepet informacioni si më poshtë, ku sipas të dhënave, të ardhurat totale janë në shumën 6.340.000 lekë:

Të ardhura të deklaruara në DPV	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Të ardhura si avokat me licence 2003 – 2009		120 000	500 000	1 800 000	1 600 000				
Të ardhura si regjisor				130 000		450 000	500 000	600 000	700000
<b>Total</b>	<b>0</b>	<b>120 000</b>	<b>500 000</b>	<b>1 930 000</b>	<b>1 600 000</b>	<b>450 000</b>	<b>500 000</b>	<b>600 000</b>	<b>700000</b>

### 6.3.2 Në lidhje me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit “noter”, i bashkëshortit të subjektit për periudhën 2012 – 2016.

Nga informacioni zyrtar që Komisioni disponon për të ardhurat e realizuara nga shtetasi A. H, i regjistruar në autoritetin tatimor me aktivitet privat “noter”, rezulton fitim neto për periudhën 2012 – 2016, në shumën prej 1.293.128 lekësh. Ndërsa subjekti në deklaratimet periodike për periudhën 2012 – 2016 ka deklaruar si të ardhura të përfituara shumën prej 2.320.000 lekësh. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga subjekti, të cilat janë konfirmuar sipas dokumentacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Informacioni i detajuar jepet në tabelën vijuese:

Të ardhura nga aktiviteti privat si noter, sipas vërtetimit të tatimeve	18 396	763 567	367 675	135 347	8 143	<b>1 293 128</b>
Të ardhura të deklaruara sipas DPV	420 000	700 000	800 000	400 000	-	<b>2 320 000</b>

- Nga analiza e kryer nga Komisioni rezultoi se ka deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, pasi të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti privat si avokat dhe noter, për periudhën 2003 – 2016, janë deklaruar në shumën prej 6.340.000 lekësh. Ndërsa të ardhurat sipas dokumentacionit të administruar në dosje janë në shumën prej 1.293.128 lekësh, fakt për të cilin subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

## 6.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

**6.4.1** Në lidhje me konstatimet e Komisionit për mospërputhje të deklaratimeve, subjekti ka pretenduar se deklaratimet periodike vjetore depozitohen në ILDKPKI nga subjektet deklaruese më herët në kohë (deri më 30 mars të çdo viti), nga sa personat fizikë marrin nga financierët e tyre bilancin vjetor, i cili paraqitet në tatime. Kjo është arsyeja që subjekti i deklarimit nuk është në dijeni efektive të shumës së saktë, objekt deklarimi tatimor.

## 6.5 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

**6.5.1** Komisioni vlerëson se prapësimet e subjektit për të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit të saj nuk u mbështetën në prova bindëse për të kundërshtuar mospërputhjet e deklarimeve. si dhe rezultatet e analizës financiare të kryer nga Komisioni. Mospërputhjet që pretendon subjekti nuk janë në shumën të vogla krahasuar me shumën e deklaruar dhe asaj të mbështetur në dokumentacion. Subjekti nuk provoi me dokumentacion të ardhurat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore.

- Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit, pasi nuk provoi burimin e ligjshëm për të ardhurat e deklaruara.

## **7. Gjetje të tjera nga Komisioni**

### **7.1 Hetimi i kryer nga Komisioni**

**Nga korrespondenca me** Universitetin “N. Y.T”<sup>42</sup>, ky i fundit<sup>43</sup>, ka informuar se për periudhën e studimit 2012 – 2014, për studenten E.H është paguar shuma prej 9.758 euro.

Komisioni konstaton se shpenzimet e shkollimit në këtë universitet nuk janë deklaruar nga subjekti, as në pyetësin e parë dërguar subjektit, dhe as në pyetësin e datës 3.8.2019, ku Komisioni i ka kërkuar specifikisht subjektit informacion për shpenzimet e shkollimit të vajzës së saj në një universitet privat. Këto shpenzime nuk janë deklaruar as në deklaratën periodike të vitit 2014, sipas detyrimeve ligjore të kohës.

Subjekti në prapësimet<sup>44</sup> e depozituara, si dhe në seancën dëgjimore të datës 24.7.2019 ka deklaruar se fëmijët e saj shkollohen me bursë dhe ka depozituar dokumentacionin përkatës, ndërkohë nuk është shprehur për shkollimin e vajzës në Universitetin “N.Y.T”. Këto shpenzime janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

- Komisioni konstatoi se subjekti ka fshehur shpenzimet e shkollimit të vajzës në Universitetin “N.Y.T”, fakt për të cilën subjektit iu kalua barra e provës.

### **7.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

**7.2.1** Në prapësimet e depozituara subjekti ka pretenduar se shpenzimet e deklaruar për shkollimin e vajzës janë pasqyruar plotësisht edhe në deklaratat e saj vjetore, si në dokumentacionet e administruara në ILDKPKI në zërin e shpenzimeve, pavarësisht titullimit dhe emrave konkretë të universitetit.

### **7.3 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave**

**7.3.1** Komisioni arsyeton se për vitet 2013 dhe 2014 subjekti ka deklaruar shpenzime në vlerën prej 900.000 lekësh, me përshkrimin shpenzime jetese. Në shpenzimet e jetesës përfshihen

<sup>42</sup> Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.8.2019, drejtuar Universitetit “N. Y. T”, ka kërkuar informacion për shkollimin e vajzës, E. H, në këtë institucion arsimor.

<sup>43</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2019.

<sup>44</sup> Subjekti, në prapësimet e datës 15.6.2019, depozituar në Komision, ka shpjeguar: |“Për sa i përket vajzës sime, të shkolluar jashtë vendit, përkatësisht në Turqi, është mbuluar tërësisht me bursë, të financuar drejtpërsëdrejti nga Universitetet respektive, shumat e të cilave kanë mbuluar shpenzimet e jetesës dhe të shkollimit, taksave, të konviktit etj., në mënyrë të plotë. Në cilësinë e provës ju vëmë në dispozicion dy certifikata të studentit ( për sistemin Bachelor dhe Master) të lëshuar nga Drejtoria e Punëve Studentore, për vajzën time, E.H, lindur më 4.1.1.1993, dokumente këto të nënshkruara dhe të vulosura nga universiteti, si dhe nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës në Qipron Lindore. Në certifikatat e mësipërme, cilësohet saktësisht se studentit, E. H, i është dhënë 100% bursë. Ky fakt pasqyrohet plotësisht edhe në deklaratat e mia vjetore dhe në dokumentacionet e administruara pranë ILDKPKI-së, dokument ky i lëshuar që më datë 26.8.2015, nga U. E. M.U, i cili informon E. H për pranimin në shkollë me një bursë të mbuluar 100% nga universiteti. Bursa të tilla, sikurse dihet botërisht, mbulojnë të gjitha shpenzimet e studentit, përfshirë ato të udhëtimeve dhe të shpenzimeve të jetesës, nga shpenzime të minimumit jetik, e deri në shpenzime të aktiviteteve kulturore të studentit (duke mos llogaritur këtu përjashtimin që i bëjnë studentit nga disa kosto dhe shpenzime suplementare si transporti urban etj”).

shpenzime shkollimi në universitetet shtetërore dhe jo shpenzimet në një universitet privat, pasi nga analiza e kryer rezulton se të ardhurat që mbeten pasi zbriten shpenzimet e shkollimit janë të pamjaftueshme për një familje me katër persona.

7.3.2 Lidhur me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të së bijës në universitetin privat për periudhën nga 2012 – 2014, ka vendosur të mos marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në lidhje me deklaratimet e këtyre shpenzimeve.

## **8. Huaja e marrë nga znj. M. B**

Në deklaratën periodike të vitit 2005 subjekti ka deklaruar hua në shumën 1.000.000 lekë shtetases M.B me qëllim mbylljen e parakohshme të kredisë në BKT. Me kërkesën e Komisionit subjekti depozitoi dokumentacion për të provuar se znj. M. B ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje nga puna si kancelare pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Subjekti depozitoi një vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2019, sipas të cilit vërtetohet se huadhënësja ka punuar si kancelare pranë këtij institucioni për periudhën shkurt 2004 – janar 2008. Nga deklaratat periodike rezulton se subjekti ka deklaruar se ka shlyer shumën prej 500.000 lekësh nga ky detyrim.

8.1 Vërehet se subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën ‘Vetting’, fakt për të cilën subjektit iu kalua barra e provës.

8.2 Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit provoi burimin e ligjshëm të huas, por nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur.

## **9. Detyrimi ndaj z. V. V**

Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën ‘Vetting’, sikurse trajtohet më sipër në pikën 2.4, detyrimin e mbetur ndaj huadhënësit, në shumën 900.000 lekë.

9.1 Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar detyrimet financiare, në përputhje me pikën ‘dh’, të nenit 4, të ligjit 9049, datë 10.4.2003, ‘Mbi deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë’ i ndryshuar, si dhe me pikën 1, të udhëzimit me nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2016, të nxjerrë nga Inspektori i Përgjithshëm pranë ILDKPKI-së, sipas të cilit subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë të dhënat e detyrueshme për deklarinin, pjesë përbërëse e këtij procesi deklarinin me përshkrimet e kërkuara sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kriterëve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti e rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri,

- i. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1991 – 2016, me një balancë - 8.800.000 lekë;
- ii. ka deklarim të pamjaftueshëm për të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit;
- iii. ka deklarim të pasaktë për shkollimin privat të vajzës, duke fshehur pagesën e kryer;

- iv. nuk justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit për huan në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016;
- v. ka deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;
- vi. nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, në kuptim të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.
2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 27.9.2019.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Suela ZHEGU**  
**Relatore**

**Xhensila Pine**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*